

## **POLITIKA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË**

**Argjiro GROUP SHPK** ka si synim përmirësimin e vazhdueshëm të strukturave, procedurave të punë, politikave dhe produkteve/shërbimeve të ofruara. Ajo përpiqet në vazhdimësi për të rritur aktivitetin e saj dhe arritur pozitën udhëheqëse në treg, përmes:

- Stafit kompetent, profesional dhe të përkushtuar.
- Përmbushjes së kërkesave dhe masave mbrojtëse në punë.
- Sigurimit të shëndetit të stafit.

**Argjiro GROUP SHPK** përmes vendosjes së objektivave të cilësisë, krijimit të kushteve të sigurisë, auditimeve të vazhdueshme të sistemit dhe rishqyrtimeve të manaxhimit drejtues, do të sigurojë një metodologji funksionale të përmirësimit të gjithë sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë në përputhshmëri me standardin ISO 45001:2018.

Është angazhimi i përhershëm i kompanisë që në vazhdimësi të plotësojë kërkesat e stafit të brendshëm. Angazhimi i saj është të ofrojë një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm për punonjësit e saj.

Kjo politikë është në përputhshmëri të plotë me politikat e përgjithshme të **Argjiro GROUP SHPK** dhe paraqet përkushtimin e kompanisë rreth plotësimin të kërkesave të stafit dhe përmbushjes së kushteve të tyre në ambjentin e punës.

**Argjiro GROUP SHPK** është e angazhuar për të siguruar një ambjent pune të sigurtë dhe të shëndetshëm për të gjithë stafin, si dhe për të siguruar informacionet, trajnimet dhe mbikëqyrjen e nevojshme për të arritur këtë qëllim.

Megjithëse kompania merr përgjegjësinë për ndjekjen e procedurave të shëndetit dhe sigurisë në punë, punonjësit duhet të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në ndjekjen dhe zbatimin e kësaj politike

Çdo punonjës inkurajohet që të luajë një rol vital dhe të përgjegjshëm në mbajtjen e një vendi pune të sigurt dhe të shëndetshëm:

- A.** Duke qenë i përfshirë në sistemin shëndetësor dhe sigurisë së vendit të punës.
- B.** Duke korigjuar procedurat dhe pajisjet.
- C.** Duke veshur uniformat mbrojtëse.
- D.** Duke përdorur pajisjet mbrojtëse.
- E.** Duke patur kujdes në hedhjen dhe trajtimin e mbetjeve të punës.
- F.** Duke raportuar çdo dhimbje ose siklet sa më shpejt të jetë e mundur.
- G.** Duke raportuar për çdo trajtim jo të kujdesshëm të mbeturinave dhe mbetjeve.
- H.** Duke siguruar që çdo aksident ose incident të raportohet.
- I.** Duke ndihmuar punëtorët e rinj, të trajnuarit dhe vizitorët në vendin e punës të kuptojnë procedurat e duhura të sigurisë dhe pse ato ekzistojnë.
- J.** Duke i raportuar manaxherit menjëherë çdo shqetësim të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- K.** Duke mbajtur vendin e punës të pastër për të minimizuar rrezikun nga ndotjet.

## **NËNSHKRIMI I ADMINISTRATORIT**

**Ilir Miho**